



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 të datës 4 qershor 2008, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 i datës 26.09.2008, si dhe neneve 4 dhe 7 të Rregullores për ndarjen e subvencioneve 15Nr.011-43473 e datës 28.06.2019 duke vendosur sipas kërkesës Nr.1-400-9141 të datës 12.02.2020 të Jakup Bahtirit drejtor i shkollës SHFMU “Vëllëzërit Frashëri” nga Lipjani, Kryetari i Komunës nxjerr:

VENDIM PËR MBËSHTETJE FINANCIARE

Neni 1

Ndahet shuma e mjeteve në vlerë prej **500 €** (pesëqind euro), sipas kërkesës Nr.1-400-9141 të datës 12.02.2020 të Jakup Bahtirit drejtor i SHFMU “Vëllëzërit Frashëri” nga Lipjani, për ta mbështetur financiarisht mbulimin e shpenzimeve për pjesëmarrje të nxënësve të shkollës SHFMU “Vëllëzërit Frashëri” në garat ndërkombëtare në lëndën e TIK-ut që do të organizohen në Shqipëri me datë 21 dhe 22 shkurt 2020.

Neni 2

Shuma e cekur nga neni 1 do të paguhet nga mjetet e buxhetit të Komunës së Lipjanit për vitin 2020, pozicioni buxhetor - subvencionet e planifikuara për Zyrën e Kryetarit të Komunës në xhironlogarinë bankare të arsimitarit Hajriz Rashiti në nr. 17-01-0030276506.41 në NLB Bank.

Neni 3

Lidhur me mjetet e shpenzuara SHFMU “Vëllëzërit Frashëri” Lipjan, duhet të sjell raport financiar-fatura deri në shumën e lejuar dhe të njëjtat ti dorëzojë në Sektorin për përfaqësim dhe çështje ligjore më së largu me datë 30.06.2020.

Neni 4

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Zyra e Kryetarit të Komunës dhe Drejtorati për Buxhet dhe Financa

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohet Hajriz Rashiti nga Lipjani si dhe SHFMU “Vëllëzërit Frashëri” Lipjan.

1Nr. 400-9141
Lipjan, më 18.02.2020

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti

